

# Oral History Kosovo

---

**Intervistuesja:** Çka kanë punu prindtë e tu?

**Narratorja:** Besa, baba ka punu në “Ramiz Sadik”, po osht’ lendu në vend të punës.

**Intervistuesja:** E çka ka punu në “Ramiz Sadik”?

**Narratorja:** Ka punu ni *preduzeq* [srb.: ndërmarrje] kështu, ka bajt prej ni venit, ni ven. Thojke do hekra, do... kur u konë në atë kohë. Edhe ka qenë qishtu ni fëmi në kerr si përpara me kuaj që i thojmë edhe tu kalue u trem kali, u hi në shitore me ble diçka edhe e ka, ja ka lëndu trunin përmrapa babës.

**Intervistuesja:** Kali.

**Narratorja:** Po kali. Edhe p’i aty, baba me 30 e kusur vite u konë i lëndun. I ka ra të fikët nonstop, e une ma së shumti e kom pasë kujdesin për çdo rrugë. Baba kur u dalë prej shpie, une jom kujdes për babën. Isha ma e vogël, ata ishin tu u shkollu vllaznit, motrat të martume. Une u kujdessha, u tutsha që p’e shkelë kerri babën edhe i shkojsa gjithë përmrapa. Se ai invalid me shtagë thojsha, qetash, nuk e dike, bojke vakia në momente kerri e shkelke. Veç ka dhonë Zoti kurrë nuk ka ndodhë rrugës kurgjo. E te shpia...

**Intervistuesja:** Kallxom pak për nonën tonde, çfarë gruje ka qenë?

**Narratorja:** Nona u konë shumë punëtore, shumë u konë punëtore, ka pasë qef shumë pastërti me majt. Une si ma e vogla që jom konë, nejse motrat tjera dishin punë të shpisë e krejt. Mu veç më thojkë, “Femra duhet m’u konë shumë me majtë pastërtinë si të trupit, si të shpisë, se qaty duhen ma së shumti”.

**Intervistuesja:** Çka ke mësu prej nonës tonde?

**Narratorja:** Prej nonës (qesh) me pastru shpinë, me bo bukën, me gatu bukë të shpisë, kemi gatu atëherë bukë të shpisë, përpara i kemi pjekë edhe në oxhak, me saç bukët. E kur shkojke nona dikun u dufke për babën që ish i smutë, u dufke m’u angazhu me to. Une pak e kisha shtirë, se a e ke pa zjarrmi e saçi e këto ma shtirë me i punue. Po s’u vonojke a di çpesh, si rrallë, se u konë ma e fortë, veç për shkak të babës u dufke m’u interesu për babën, kujdesja tij.

**Intervistuesja:** E prej babës çka ke mësu?

**Narratorja:** Prej babës, thojke baba, “Ma së shumti babo shkollën merre. Mëso shkollën, se kom qef m’u bo mjeke” (qesh), qato gjithë e ka pasë qef baba. Po ashtu arriti që nona ishte smutë, u bo operacion prej zorrës qorre edhe u duhsha m’u kujdes une për nanën. Ni moment tani, shkoi ni kohë, e hupa deri në gjashtë, ma shumë nuk mujta.